



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 665/1 Prot.

Tiranë, më 07.04.2026

V E N D I M

Nr. 74, Datë 07.04.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 146, datë 24.06.2025¹, e z. V.A kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me email-in datë 02.07.2025, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Jam pjesëtar i komunitetit egjiptian dhe banoj në një banesë të ndërtuar në mënyrë informale, me sipërfaqe prej 24 m². Këtë ndërtim e kam vetëdeklaruar nëpërmjet aplikimit nr. 2241, datë 21.03.2005. Që prej asaj kohe, janë kryer dy herë matje nga institucionet përkatëse. Hera e fundit ka qenë në janar 2023, kur punonjësi R.M kreu matjet pas ndërhyrjes së Qendrës për të Drejtat e Grave Rome, e cila ka advokuar në emrin tonë.

Pavarësisht këtyre veprimeve dhe ndihmës së ofruar, procesi i legalizimit të banesës sime nuk është përfunduar, dhe nuk kam marrë asnjë njoftim apo vendim nga ASHK. Përfaqësuesit e Qendrës për të Drejtat e Grave Rome kanë marrë një përgjigje formale nga ASHK Tirana Veri, (shkresa nr. 11873/1, datë 23.02.2024) në të cilën thuhet se shqyrtimi i praktikave për legalizim kryhet në bazë të organizimit të punës sipas njësive strukturore të quajtura “Bllok Kadastral”, duke u dhënë përparësi zonave që janë miratuar më parë ose që kanë aplikuar më herët.

¹ Ankesa është plotësuar me informacionin e dërguar me email-in datë 02.07.2025.

² Referuar Vërtetimit nr. 259, datë 23.06.2025, të lëshuar nga Qendra për të Drejtat e Gruas Rome, vërtetohet se ankuesi i përket minoritetit Egjiptian.

Megjithatë, dua të theksoj se aplikimi im daton që prej vitit 2005, çka tregon se kam aplikuar shumë herët dhe nuk ka arsye të justifikohet vonesa me rendin e aplikimeve.

Ndërkohë, shumica e banesave të ndërtuara në mënyrë informale nga banorë të komuniteteve jo rome dhe jo egjiptiane, si: F.D; E.K dhe M.K, të cilët banojnë në të njëjtën rrugë, janë legalizuar dhe kanë përfituar dokumentacionin përkatës. Ky fakt përforcon bindjen time se në praktikë po zbatohet një trajtim i pabarabartë dhe selektiv.

Besoj se vonesat e pajustificuara dhe mungesa e përgjigjes ndaj aplikimit tim lidhen me përkatësinë time etnike si pjesëtar i komunitetit egjiptian, si dhe me mungesën e fuqisë ekonomike dhe mbështetjes institucionale. Për këtë arsye ndjej se jam trajtuar në mënyrë diskriminuese në procesin e legalizimit”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfundimin e procesit të legalizimit të banesës së tij.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo duhej të plotësohej me dokumentacion shtesë. Me email e datës 30.06.2024, nga inspektori i çështjes, është kërkuar nga ankuesi të depozitohet informacion të mëtejshëm në lidhje me çështjen, si më poshtë vijon:

- Kërkohej të parashtrihen nga ju argumente dhe prova bashkëngjitur, sa i përket shkakut të pretenduar të “gjendja ekonomike”. Pra, arsyet ku lidhet diskriminimi i pretenduar nga ana juaj me gjendjen ekonomike, ndërkohë që keni dërguar Vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, në të cilin ankuesi Z. V.A, rezulton i punësuar dhe me të ardhura nga punësimi. Në këtë rast kërkohen fakte dhe prova të gjendjes ekonomike të familjes V.A (vërtetim papunësie, trajtimi me ndihmë ekonomike, etj).
- Në ankese keni informuar se: *“shumica e banesave të ndërtuara në mënyrë informale nga banorë të komuniteteve jo egjiptiane në të njëjtën rrugë janë legalizuar”*. Lidhur me këtë deklaram kërkohen fakte dhe prova: emrat e banorëve që janë legalizuar dhe që janë në të njëjtën parcelë kadastrale apo komshi me ankuesin Z. V.A.
- Informacion nëse çështja objekt shqyrtimi është kundërshtuar në gjykatë. Nëse po, kopje të Kërkesë Padisë, kundërshtimit të palës tjetër apo vendimit të gjykatës, nëse ka.

Në vijim me email e datë 02.07.2025, nga ana e palës ankuese u kthye përgjigje për informacionin e kërkuar.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe ajo u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën me nr. 820/2, datë 04.07.2025 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore të ASHK, Tirana Veri, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Informacion lidhur me problematikën dhe pretendimet e paraqitura nga subjekti ankues.
 - Informacion lidhur me procedurat e ndjekura mbi rastin e ankuesit, si dhe të evidentohen arsyet e moskryerjes së legalizimit të objektit të tij nga viti 2005, deri aktualisht.
 - Kopje e korrespondencës zyrtare të institucionit, me ankuesin përgjatë periudhës 2005-2025;
 - Kopje të plotë të praktikës shkresore/procedurës së ndjekur nga ana juaj, lidhur me rastin e legalizimit të banesës së z. V.A;
 - Informacion mbi banorë të tjerë, të kësaj zone që kanë ndërtuar pa leje dhe kanë depozituar kërkesë për legalizim pranë institucionit tuaj, në të njëjtën periudhë kohore (viti 2005) me ankuesin;
 - Informacion mbi faktin se sa prej këtyre objekteve janë legalizuar. Të dërgohen kopje të akteve përkatëse të legalizimit;
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit (*respektivisht kopje e kërkesës për aplikim (formulari i vetëdeklarimit) dhe të vendimit për legalizim të objektit, për secilin subjekt*) për pasuritë e shtetasve, si më poshtë citohen:
 1. Për pasurinë në pronësi të shtetasit F.D.
 2. Për pasurinë në pronësi të shtetasit E.K.
 3. Për pasurinë në pronësi të shtetasit M.K.
 - Si dhe çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
- Me shkresën nr. 9194/1, datë 16.07.2025, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, i ka përcjellë për trajtim Drejtorisë Vendore të Agjencisë së Kadastrës Tirana Veri, shkresën nr. 820/2, datë 04.07.2025 të Komisionerit.

Me shkresën nr. 6712/1, datë 13.08.2025, Drejtoria Vendore të Agjencisë së Kadastrës Tirana Veri, informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi në bazën e të dhënave dixhitale të vetëdeklarimeve për subjektet informale në proces legalizimi, që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, figuron vetëdeklaruesi subjekti V.A me nr. 2241 prot., datë 21.03.2005. Referuar dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se në një nga dhomat e planimetrisë së objektit ndodhet shtyllë e linjës së transmetimit elektrik.*

Ndodhur në këto kushte, nuk është vijuar me përfundimin e procedurave administrative sipas ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe

VKM-së nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje””.

- Me emailin e datës 25.08.2024, nga inspektori i çështjes i është përcjellë palës ankuese përgjigja e kthyer nga Drejtoria Vendore e Agjencisë së Kadastrës Tiranë Veri, për të bërë parashtrimet e saj në lidhje me këtë përgjigje.
- Me email e datës 27.08.2024, nga ana e palës ankuese u kthye përgjigje si më poshtë vijon:

“Sipas z. V.A, ai nuk është njoftuar asnjëherë se procesi i legalizimit ishte pezulluar për shkak të pranisë së një shtylle tensioni. Nëse një informacion i tillë do t’i ishte bërë i ditur, ai do të kishte ndërmarrë menjëherë hapat përkatës, pasi në vitin 2015, OSHEE ka kryer rinovimin e plotë të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në këtë zonë dhe shtylla në fjalë është larguar nga ambientet e objektit.

Për më tepër, së fundmi, z. V.A i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke kërkuar përfundimin e procedurës së aplikimit për legalizim. Në datën 18.01.2025, kjo Drejtori i është drejtuar zyrtarisht Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tiranë Veri, duke kërkuar kryerjen e veprimeve verifikuese në terren. Pavarësisht kësaj, deri më sot nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret nga ana e kësaj Drejtorie Vendore”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 820/5, datë 09.10.2025 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 21.10.2025, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe ka kërkuar nga subjekti dokumentet si më poshtë:
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit (respektivisht kopje e kërkesës për aplikim (formulari i vetëdeklarimit) dhe të vendimit për legalizim të objektit, për secilin subjekt) për pasuritë e shtetasve, si më poshtë citohen:
 1. Për pasurinë në pronësi të shtetasit F.D.
 2. Për pasurinë në pronësi të shtetasit E.K.
 3. Për pasurinë në pronësi të shtetasit M.K.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 21.10.2025, me praninë e të dy palëve në proces: subjekti ankues, i përfaqësuar nga znj. M.V dhe përfaqësuesit me autorizim datë 20.10.2025, të ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, z. J.B.

Gjatë seancës dëgjimore, palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit me email dhe shkresor me KMD-në.

Gjatë seancës dëgjimore, Komisioneri paraprakisht ftoi palët për një zgjidhje me ndërmjetësim, për të cilën përfaqësuesi i ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri deklaroi se në këtë rast është i pamundur sepse në ndërtesë ka një objekt dhe kjo do të çonte në skualifikim.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesja e ankuesit deklaroi se: *“Ankuesi ka bërë kërkesë pranë Kadastrës në vitin 2023 dhe 2025 dhe asnjëherë nuk është informuar se problematika qëndron tek shtylla elektrike. OSHEE e ka hequr shtyllën që në vitin 2015”*.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, deklaroi se: *“Në planimetrinë e objektit në fjalë rezulton se është një shtyllë elektrike dhe ne nuk kemi informacion mbi heqjen e kësaj shtylle, por do organizojmë një inspektim për verifikimin në terren. Ne do komunikojmë shkresërisht me OST dhe OSSH, lidhur me shtyllën elektrike.*

Lidhur me vonesën e procedurës së legalizimit, ju informojmë se ka shumë aplikime që nuk janë përfunduar, si dhe në rastin e 3 aplikimeve që keni kërkuar informacion, ku dy aplikime janë me leje legalizimi, ndërsa një rast është aplikim i patrajtuar”.

- Në mbështetje të neneve 78-86 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 32, pika 1, shkronja c), dhe pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe nenit 39, të Rregullores së Brendshme *“Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”³*, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 136, datë 12.11.2025, të Komisionerit, në datën 14.11.2025, inspektorët e KMD-së në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore Tirana Veri të ASHK-së, realizuan inspektim në banesën e subjektit ankues.

Gjatë inspektimit me përfaqësuesit e Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana Veri, nga inspektorët e KMD-së, u mbajt procesverbali përkatës, në të cilin u evidentua fakti se shtylla e tensionit nuk ishte në mjediset e brendshme të banesës, por ishte zhvendosur në mjediset e jashtme të banesës, në anë të rrugës automobilistike. Nga grupi i punës të Drejtorisë Vendore Tirana Veri u kryen verifikimet dhe matjet e banesës të cilat do të reflektohen në dosjen e legalizimit të ankuesit. Rezultoni se banesat e z. M.K dhe E.K janë në kufirin e pasëm të banesës së ankuesit.

Me shkresën nr. 10851, datë 25.11.2025, Drejtoria Vendore e ASHK-së Tirana Veri, i është drejtuar Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Drejtorisë Rajonale Tiranë të OSHEE, në të cilën ka kërkuar informacionin si më poshtë: *“Lutemi që brenda një afati të arsyeshëm, pas kryerjes së verifikimeve të nevojshme të na informoni nëse objekti informal i vetëdeklaruar pranë Njesisë Administrative nr. 11, Tiranë, në posedim të subjektit Z. V.A, shkel/cënon brezin mbrojtës të sistemit të linjave ekzistuese të interkonjeksionit, apo është ngritur në zonën e sigurisë të nënstacionit elektrik”*.

³ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

Me shkresën nr. 119, datë 13.01.2026, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe OSHEE Drejtoria Rajonale Tiranë, lidhur me Shkresën nr. 10851, datë 25.11.2025, të dërguar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri.

Me shkresën nr. 555, datë 20.01.2026, OST informoi se: *“Në përgjigje të shkresës me lëndë: “Kërkesë për informacion, lidhur me shkresën nr. 10851, datë 25.11.2025, të dërguar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri”, ju bëjmë me dije se: “OST sh.a në vijim të kërkesës nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri me shkresën nr. 10851, datë 25.11.2025, për vënie në dispozicion, informacioni me qëllim “Legalizimi i objekteve informale”, i është përgjigjur Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me shkresën nr. 6320/1, datë 09.12.2025, në të cilën i ka bërë me dije se:*

Objekti në pronësi të z. V.A nuk ndodhet poshtë apo në afërsi të linjave të tensionit të lartë nën administrimin e OST sh.a. Si rrjedhojë japim miratimin tonë për vazhdimin e procedurave”.

Me shkresën nr. 144/1, datë 23.01.2026, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Tiranë informoi se: *“Referuar shkresës suaj në të cilën kërkohet informacion për shkresën nr. 10851, datë 25.11.2025 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, mbi objektin informal të vetëdeklaruar pranë Njësisë Administrative nr. 11 në posedim të subjektit Z. V.A, ju bëjmë me dije se: “Drejtoria Rajonale Tiranë nuk ka në administrim Linja interkonjeksioni dhe N/Stacione elektrike, e për rrjedhojë verifikimet përkatëse nuk janë kompetencë e Drejtorisë Rajonale Tiranë OSSH sh.a””.*

Shkresat e dërguara nga OST dhe OSSH Drejtoria Rajonale Tiranë, me email-et datë 22.01.2026 dhe 26.01.2026, i janë përcjellë Drejtorisë Vendore Tirana Veri.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfituar të mira apo shërbime nga ana e Drejtorisë Vendore, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Veri, dhe më konkretisht në lidhje me legalizimin e banesës së tij.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe në analizë të sa më sipër, rezultoi se:

Në bazë të vetëdeklarimit nr. 2241, datë 21.03.2005, shtetasi V.A ka aplikuar për legalizimin e objektit informal me emërtimin “shtëpi banimi”, me sipërfaqe të përgjithshme të zënë prej 110 m² truall, nga e cila 40 m² ndërtesë, në adresën rruga “E Paskuqanit”, krahu i majtë, Tiranë.

Në lidhje me vetëdeklarimin e mësipërm, është lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së një vërtetim nr. 812561, datë 19.01.2023, i cili konfirmon këto fakte, vërtetim i cili ishte lëshuar me kërkesë të të interesuarit.

Nga dokumentacioni i administruar me ankesën e bërë pranë Komisionerit, rezulton se me kërkesën nr. 11873, datë 13.12.2023, është administruar pranë Drejtorisë Vendore të Agjencisë së Kadastrës Tiranë Veri, kërkesa e znj. M.V, me anë të së cilës është kërkuar informacion në lidhje me vijimin dhe lehtësimin e procedurave administrative të legalizimit të ndërtimeve informale në posedim të banorëve romë, me adresë në Njësinë Administrative nr. 11, Tiranë.

Me shkresën nr. 11873/1, datë 23.02.2024, Drejtoria Vendore e Agjencisë së Kadastrës Tiranë Veri ka kthyer përgjigje kërkueses, ku ka informuar se: *“Drejtoria Vendore e Agjencisë së Kadastrës Tiranë Veri ju bën me dije se, sipas shkresës nr. 689, datë 11.01.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së, shqyrtimi i praktikave të legalizimit për objektet informale kryhet nga Drejtoritë Vendore në përputhje me organizimin e punës sipas njërive strukturore “bllok kadastral”, duke u dhënë përparësi zonave informale të miratuara sipas kohës së aplikimit, pasi është e drejta e subjekteve që kanë aplikuar të parët të marrin shërbimin e kërkuar, pra vetëdeklarimet e aplikuar në vitet 2005-2006. Në momentin e përfshirjes së praktikave të legalizimit në planin e punës së kësaj Drejtorie, do të bëhet e mundur trajtimi i tyre dhe verifikimi i problematikave që mund të hasen gjatë shqyrtimit administrativ, për të cilat do të informoheni nga Drejtoria Vendore e Agjencisë së Kadastrës Tiranë Veri”.*

Ndërkohë që nga ana e subjektit ankues është bërë një kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, protokolluar me nr. 14074, datë 31.12.2024, me anë të së cilës ka kërkuar konkludimin e procedurave për legalizimin e ndërtimit pa leje në posedim të tij.

Në vijim, me shkresën nr. 926, datë 17.01.2025, Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së i ka përcjellë Drejtorisë Vendore të Agjencisë së Kadastrës Tiranë Veri kërkesën e palës ankuese, ku i kërkon marrjen e masave për kryerjen e verifikimeve përkatëse dhe trajtimin administrativ të rastit në përputhje me ligjin nr. 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”* dhe VKM-së nr. 1040, datë 25.11.2020 *“Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.*

Me shkresën nr. 6712/1, datë 13.08.2025, Drejtoria Vendore të Agjencisë së Kadastrës Tirana Veri, informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi në bazën e të dhënave dixhitale të vetëdeklarimeve për subjektet informale në proces legalizimi, që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së, figuron vetëdeklaruesi subjekti V.A me nr. 2241 prot., datë 21.03.2025. Referuar dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se në një nga dhomat e planimetrisë së objektit ndodhet shtyllë e linjës së transmetimit elektrik. Ndodhur në këto kushte, nuk është vijuar me përfundimin e procedurave administrative sipas ligjit nr. 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”* dhe VKM-së nr. 1040, datë 25.11.2020 *“Për**

përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”.

Për sa më sipër, së pari sqarojmë se vetëdeklarimi i ankuesit është depozituar pranë ish-ALUIZN-it, Drejtorisë Tiranë, i cili ka funksionuar deri në vitin 2018, periudhë në të cilën u miratua ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, nëpërmjet së cilit është krijuar Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila ndër të tjera mori edhe funksionet e ish-ALUIZN-it. Ndërkohë që, nëpërmjet Urdhrit nr. 470, datë 06.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës, “Për përcaktimin e kompetencës së disa Drejtorive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës” janë përcaktuar gjithashtu edhe kompetencat e Drejtorive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të cilat do të shqyrtojnë në vijim kërkesat për legalizim të objekteve informale, të cilat ishin ende të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale të ALUIZN-it.

Në referencë të nenit 5, të Ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Agjencia Shtetërore e Kadastrës është institucioni publik që organizohet dhe funksionon në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kadastrën. ASHK është autoriteti publik përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe për koordinimin e proceseve në bashkëpunim me institucionet dhe organet e tjera qendrore shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo ndërmjet strukturave në përbërje të saj, me qëllim përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

Referuar parashikimit të nenit 6, pika 1 të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që krijohet me këtë ligj dhe funksionon si institucion me vetëfinancim.

Në nenin 67 të ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht:

1. *“Agjencia Shtetërore e Kadastrës krijohet si bashkim i AITPP-së, ALUIZNI-t dhe ZRPP-së.*
2. *Agjencia Shtetërore e Kadastrës krijohet jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.*
3. *Pas krijimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike i ngarkohen ASHK-së”.*

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se pavarësisht faktit se në vitin 2018, është kryer një riorganizim institucional, duke krijuar institucionin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtoritë e saj rajonale, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të suprimuara janë trashëguar tek institucionet e reja. Janë pikërisht Drejtoritë Rajonale të ASHK-së që shqyrtojnë dosjet e deklarimeve të pashqyrtuara nga ana e ish-ALUIZN-it.

Sipas parashikimeve të bëra në nenin 4 “Përkufizime”, pika 12, të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën, është përcaktuar se: “12. “Ndërtim pa leje” është ndërtimi i lidhur në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose me ndërtesa të tjera, i cili është bërë pas datës 10.8.1991 dhe paraqitet në një nga këto lloje: a) objekti, apo shtesa në ndërtim të regjistruar, pavarësisht funksionit të tij, që është kryer në mungesë të një lejeje ndërtimi”.

Në referencë të nenit 5, të ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është institucioni publik që organizohet dhe funksionon në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kadastrën. ASHK është autoriteti publik përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe për koordinimin e proceseve në bashkëpunim me institucionet dhe organet e tjera qendrore shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo ndërmjet strukturave në përbërje të saj, me qëllim përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

Në nenet 18, 20 dhe 21, të ligjit 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet si më poshtë citohet:

“18. Kriteret për legalizim

1. ASHK-ja kryen procedurat e kualifikimit për legalizim të ndërtimeve pa leje, duke u bazuar në kriteret e moscenimit të:

a) veprave kryesore të infrastrukturës publike;

b) akseve rrugore kombëtare;

c) territorit apo funksionalitetit të ndërtesave publike;

ç) integritetit të pasurive kulturore materiale, sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore dhe muzetë;

d) territoreve të destinuara për investime strategjike, sipas legjislacionit në fuqi për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë;

dh) vijës bregdetare, në kuptim të interesit publik në zhvillimin e turizmit.

2. Ndërtimet pa leje që cenojnë kriteret e mësipërme nuk legalizohen. Ato regjistrohen në bazën e të dhënave vetëm për efekt njohjeje të vlerës së investimit të ndërtimit, sipas parashikimeve në nenin 33 të këtij ligji.

3. Për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, kriteret e mësipërme sjellin moslegalizim vetëm për sipërfaqet në tejkalim të lejes së ndërtimit, kur ato janë të ndashme nga ndërtimi me leje. Në rastin kur këto sipërfaqe nuk janë të ndashme, objektet me shkelje të lejes së ndërtimit legalizohen në tërësi.

4. Procedurat, rregullat dhe dokumentacioni për zbatimin e këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20, Dokumentacioni për legalizim

1. Dokumentacioni për legalizimin e ndërtimit pa leje përfshin:

a) genplanin e ndërtimit;

b) planimetrinë e çdo kati të ndërtimit dhe sipërfaqet në m²;

c) aktekspertizat nga një ekspert ose ent i licencuar për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit, për ndërtimet me lartësi mbi 4 kate, si dhe për shtesën në ndërtim të regjistruar dhe për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit.

2. Për objektet me shkelje të lejes së ndërtimit, në dokumentacionin e legalizimit, përveç sa parashikohen në pikën 1, të këtij neni, ASHK-ja administron edhe aktmarrëveshjen me pronarin e truallit për ndërtimin kryesor, nëse është ndërtuar në territor privat, si dhe aktmarrëveshjen për

shtesën, nëse ka të tillë. Në mungesë të aktmarrëveshjes për shtesën, të drejtat dhe detyrimet e palëve për ndërtimin kryesor njësohen me të drejtat dhe detyrimet e palëve në shtesën pa leje.

Neni 21, Legalizimi i ndërtimit

- 1. ASHK-ja, brenda 60 ditëve nga përfundimi i procedurave të kualifikimit, legalizon ndërtimin, duke respektuar dispozitat e legjislacionit në fuqi për regjimet pasurore martesore.*
- 2. Poseduesi i ndërtimit pa leje ka të drejtë të kërkojë përfundimin e procedurave administrative, sipas këtij seksioni, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, kundrejt pagesës së një tarife shërbimi shtesë, e cila është e detyrueshme pavarësisht nëse ndërtimi legalizohet ose jo.*
- 3. Modeli dhe rregullat për nxjerrjen e aktit të legalizimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*
- 4. Gjatë procedurave administrative, sipas këtij seksioni, poseduesi i ndërtimit pa leje, me vullnetin e tij, mund të heqë dorë nga e drejta për të përfutur legalizimin, nëpërmjet një deklarate noteriale. Me administrimin e kësaj deklarate, ASHK-ja përfundon procedurën administrative dhe vendos përjashtimin e ndërtimit nga legalizimi”.*

Në pikën 5, të Vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, parashikohet shprehimisht se:

“5. Legalizimi i ndërtimeve pa leje nga drejtoritë vendore të ASHK-së bazohet në gjendjen faktike të tyre dhe në kriteret e përcaktuara në mënyrë shteruese në këtë vendim. Për efekt të procedurave kualifikuese, drejtoritë e ASHK-së bashkëpunojnë me institucione të tjera, duke iu përmbajtur parashikimeve të këtij vendimi. Institucionet janë të detyruara të shprehen mbi kërkesat e drejtorive vendore të ASHK-së brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e tyre. Në rast moskthimi të përgjigjes brenda këtij afati, ASHK-ja njofton organin epror të institucionit dhe/ose Kryeministrin”.

Sikurse doli nga aktet e vëna në dispozicion gjatë hetimit administrativ të rastit rezultoi se Drejtoria Vendore, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë Veri, nuk i ka kthyer përgjigje ankuesit lidhur me statusin e aplikimit për legalizim të banesës së tij.

Sa më sipër ankuesi ngre pretendimin se ai nuk është njoftuar asnjëherë se procesi i legalizimit nuk ishte bërë për shkak të pranisë së një shtylle të transmetimit elektrik. Nëse një informacion i tillë do t'i ishte bërë i ditur, ai do të kishte ndërmarrë menjëherë hapat përkatës, pasi në vitin 2015, OSHEE ka kryer rinovimin e plotë të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në këtë zonë dhe shtylla në fjalë është larguar nga ambientet e objektit.

Së pari, nga informacioni i administruar gjatë shqyrtimit të ankesës, rezulton se procesi i legalizimit, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe praktikës së ndjekur nga zyrat vendore të legalizimit, zhvillohet në mënyrë të etapizuar, sipas rendit kronologjik të aplikimeve dhe ndarjes në blloqe kadastrale. Ky proces kryhet hap pas hapi, në përputhje me organizimin e punës së brendshme të strukturave përkatëse dhe në zbatim të përparësive ligjore, ku përparësi u jepet vetëdeklarimeve të kryera në

vitet e para të zbatimit të ligjit për legalizimin, 2005-2006. Në këtë kuadër, shqyrtimi i praktikave individuale dhe vijimi i procedurave administrative bëhet vetëm pas përfshirjes së zonës përkatëse në planin e punës të Drejtorisë Vendore, duke respektuar në çdo rast parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Së dyti, Drejtoria Vendore e Agjencisë së Kadastrës Tiranë Veri me shkresën nr. 6712/1, datë 13.08.2025, me lëndë “Kthim përgjigje” Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka informuar për herë të parë ankuesin, për arsyen e mosvijimit të shqyrtimit të aplikimit të tij, me justifikimin se në një nga dhomat e planimetrisë së objektit ndodhet një shtyllë e transmetimit elektrik.

Së treti, ankuesi ka informuar se shtylla e transmetimit elektrik është zhvendosur që në vitin 2015 dhe nga inspektimi i kryer në datë 14.11.2025, rezultoi se në objektin e ankuesit nuk kishte shtyllë të transmetimit elektrik. Gjithashtu dhe OST me shkresën nr. 6320/1, datë 09.12.2025, drejtuar Drejtorisë Vendore Tirana Veri ka dhënë miratimin për vazhdimin e procedurave të legalizimit të objektit në pronësi të ankuesit.

Së katërti, Drejtoria Vendore Tirana Veri, nga data 21.03.2005, kur është bërë aplikimi dhe deri në datë 14.11.2025, kur u krye inspektimi i përbashkët, nuk ka kryer asnjë veprim administrativ për legalizimin e objektit të z. V.A.

Së pesti, nga data 09.12.2025, kur OST ka kthyer përgjigje për objektin e ankuesit, deri me datë 26.01.2026, kur Drejtoria Vendore Tirana Veri është njohur me përgjigjen e OSSH, Drejtoria Vendore Tirana Veri nuk ka kryer asnjë veprim lidhur me trajtimin e aplikimit të bërë nga ankuesi.

Mosrespektimi i kufirit kohor prej dy muajsh për përfundimin e procedurës administrative në rastin objekt shqyrtimi, është i dukshëm, dhe nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Veri nuk është dhënë asnjë justifikim i arsyeshëm për mosrespektimin e këtij afati procedural për përfundimin e procedurës administrative edhe nëse do të ekzistonte ndonjë situatë e veçantë, e parashikuar nga neni 91/4 të Kodit të Procedurave Administrative.

Procedura e legalizimit të objektit të z. V.A, nuk është përfunduar nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Veri, pa asnjë shkak të justifikuar ligjërisht edhe pse ankuesi është interesuar që në vitin 2023 dhe 2024.

Në ligjin nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, në ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe në VKM nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimit e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, nuk mund të thuhet se nuk ka afate kohore për përfundimin e procedurave të legalizimit. Kur aplikimi është në përputhje me dokumentacionin e parashikuar në nenin 20, të ligjit nr. 20/2020, (gjë që është përmbushur në rastin konkret), atëherë ASHK-ja verifikon kriteret e kualifikimit për legalizim sipas nenit 18, të ligjit sipërcituar. Vlerësimi i kriterëve formale është faza e parë e procedurës, e cila nuk mund të tejzgjatet, sidomos kur në vitin 2015, ishte zhvendosur dhe shtylla elektrike. Kjo

procedurë kualifikuese duhej të ishte ezauruar me kohë nga DV ASHK-ja për të kaluar më tej në fazën e dytë, sipas nenit 21, të ligjit 20/2020, ku ASHK -ja legalizon ndërtimin brenda 60 ditëve nga përfundimi i procedurave të kualifikimit.

Gjithsesi, edhe nëse do të ndodheshim në mungesë të parashikimit të afateve, si për çdo organ tjetër administrativ vendimmarrës, zbatohen afatet e parashikuara në nenin 91/2/3 të Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin përcaktohet se: “2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë. 3. Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”.

Lidhur me procedurën e ndjekur nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Veri, në raste të ngjashme me atë të ankuesit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i kërkoi këtij të fundit, informacion për statusin e legalizimit për pasuritë e shtetasve, të cilët janë në të njëjtën zonë me ankuesin: F.D, E.K dhe M.K.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, ASHK Tirana Veri vuri në dispozicion praktikën e legalizimit të këtyre shtetasve, të cilët janë në të njëjtën zonë me pronën e z. V.A.

Në analizë të dokumentacionit të shqyrtuar rezultoi se:

- F.D nëpërmjet formularit të Vetëdeklarimit për legalizim, ka aplikuar për legalizimin e banesës së tij në datë 02.11.2006 (praktika e legalizimit nr. 5499). ASHK Tirana Veri me Vendimin nr. 14669, datë 24.11.2016, ka vendosur për legalizimin e ndërtimit pa leje, të poseduar nga F.D.
- E.K nëpërmjet formularit të Vetëdeklarimit për legalizim, ka aplikuar për legalizimin e banesës së tij në datë 02.11.2006 (praktika e legalizimit nr. 5000). ASHK Tirana Veri me Vendimin nr. 12380, datë 18.01.2016, ka vendosur për legalizimin e ndërtimit pa leje, të poseduar nga E.K.
- M.K nëpërmjet formularit të Vetëdeklarimit për legalizim, ka aplikuar për legalizimin e banesës së tij në datë 14.11.2006. Nuk ka një vendim të ASHK Tirana Veri për këtë aplikim.

Në një analizë krahasuese të procedurave të legalizimit mes z. V.A dhe z. F.D dhe z. E.K, të ndjekura nga ASHK Tirana Veri, rezultoi se z. F.D ka kryer procesin e vetëdeklarimit në datë 02.11.2006 dhe ASHK Tirana Veri ka vendosur për legalizimin në datë 24.11.2016, ndërsa z. E.K ka aplikuar në datë 02.11.2006 dhe ka marrë vendimin e legalizimit në datë 18.01.2016, ndërkohë që z. V.A ka kryer procesin e vetëdeklarimit në datë 21.03.2005 dhe nuk ka një vendim për legalizimin apo jo të banesës së tij.

Pra, nga analizimi i procedurave të sipërcituara, rezultoi se z. F.D dhe z. E.K kanë kryer procesin e vetëdeklarimit rreth 1 vit e gjysëm pas z. V.A, ndërkohë që ASHK Tirana Veri ka kryer procedurat e legalizimit për objektet e përmentura që në vitin 2016. Në këtë mënyrë evidentohet dhe trajtimi i

pabarabartë i këtyre subjekteve që kishin ndërtime të paligjshme të cilët ishin në kushte të barabarta, pasi pronat e tyre janë kufitarë dhe në të njëjtën zonë me ankuesin.

Në analizë të gjithë sa më sipër, rezulton se vonesa në shqyrtimin e dokumentacionit dhe mbylljen e procedurave të legalizimit për objektin e z. V.A është bërë pa një shkak ligjor të justifikuar. Në referencë të parashikimeve ligjore që parashikojnë afatet e procedurave administrative të legalizimit, është më se e qartë se ligji ngarkon institucionin e ASHK Tirana Veri me barrën e provës për të vërtetuar mosrespektimin e këtij afati. Gjatë shqyrtimit të ankesës, ASHK DV Tirana Veri, edhe pas verifikimeve dhe matjeve të bëra në datë 14.11.2025, nuk arriti të justifikojë arsyet e vonesës në shqyrtimin e dokumenteve të legalizimit të objektit të z. V.A.

ASHK Tirana Veri nuk ka kryer në kohë të arsyeshme, efektive, procedurat e kualifikimit për legalizimin e objektit pa leje të ankuesit, sipas përcaktimeve të nenit 18, të ligjit 20/2020.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, ankuesi z. V.A, i është nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e ASHK DV Tirana Veri, lidhur me mostrajtimin në kohë dhe në afat ligjor të kërkesës së tij për legalizim objekti informal.

B. Shkaku i mbrojtur

Mbështetur në nenin 2⁴, të ligjit nr. 10221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, shkaku i poseduar nga subjekti ankues, konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar provën shkresore e cila faton se e mbart atë.

⁴“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohej vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Nocioni “racë” i ka rrënjët në idenë e klasifikimit biologjik të qenieve njerëzore në nën-specie sipas tipareve morfologjike, si ngjyra e lëkurës apo karakteristikat e fytyrës. Dokumentet ligjore të BE-së dhe ato ndërkombëtare përdorin nocionin e diskriminimit racor ndërkohë që kundërshtojnë në mënyrë eksplicite nocionin e racave të veçanta njerëzore. Ndalimi i diskriminimit në bazë të origjinës racore ose etnike mund të mbulojë gjithashtu diskriminimin bazuar në ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare. Ky shkak lidhet shpesh edhe me shkakun tjetër të parashikuar që është ai i ngjyrës. Në Shqipëri, diskriminimi për shkak të racës është lidhur kryesisht me pakicat kombëtare romë dhe egjiptiane⁵.

Përkufizimi më gjerësisht i pranuar mbi racën është ai i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e Gjithë Formave të Diskriminimit Racor. Në nenin 1, kjo Konventë, përkufizon diskriminimin racor si çdo dallim, përjashtim ose privilegjim në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës ose origjinës nacionale ose etnike, që ka për qëllim pamundësimin ose vështirësimin të pranimit, gëzimit apo ushtrimit të bazës së barabartë të të drejtave dhe lirive bazë të njeriut në fushën e jetës ekonomike, shoqërore, kulturore, si dhe fusha tjera të jetës publike⁶. Në kontekstin rajonal evropian, me rëndësi është përkufizimi i Komisionit Evropian kundër racizmit dhe tolerancës (ECRI), sipas së cilit, racizmi dhe diskriminimi racor lidhen me bazat racë, ngjyrë të lëkurës, fe, nacionalitetet ose origjinë nacionale ose etnike⁷.

Përkatësia etnike shpesh konsiderohet si pjesë e diskriminimit racor. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KDESK) konsideron përkatësinë etnike si shkak të mbrojtur për diskriminim, dhe si pjesë të mbrojtjes nga diskriminimi në bazë të racës dhe ngjyrës së lëkurës⁸. Sipas GjEDN-së, përkatësia etnike nxjerr origjinën nga idea mbi grupet shoqërore, tipari kryesor i të cilave është origjina e përbashkët nacionale, lidhshmëria me një fis të caktuar (ang. tribe), bindje fetare, gjuhë të përbashkët, ose origjinë dhe prapavijë kulturore dhe tradicionale⁹.

GJEDNJ-ja në çështjen Timishev kundër Ruisë, ka mbajtur qëndrimin se: “Përkatësia etnike dhe raca janë koncepte të lidhura dhe të mbivendosura. Megjithëse nocioni i racës është i rrënjësor në

⁵ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

⁶ Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor. Neni 1

⁷ ECRI General policy recommendation No. 7 on national legislation to combat racism and racial discrimination. *Council of Europe Website*.

<http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/gpr/en/recommendation_n7/ecri03-8%20recommendation%20nr%207.pdf>.

⁸ Komenti i përgjithshëm nr. 20 i Komitetit për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. paragrafi 19

⁹ Timishev v Russia (2007) 44 EHRR 776. para.55

idenë e klasifikimit biologjik të qenieve njerëzore në nënspecie sipas karakteristikave morfologjike të tilla si ngjyra e lëkurës apo karakteristikat e fytyrës, përkatësia etnike e ka origjinën e vet në idenë e grupeve shoqërore të shënuar nga kombësia e përbashkët, përkatësia fisnore, besimi fetar, gjuha e përbashkët, ose origjina dhe prejardhja kulturore dhe tradicionale¹⁰”.

Ligji nr. 97/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6¹¹, të tij, sanksionon se: “Çdo person ka të drejtë të deklarojë përkatësinë në një pakicë kombëtare, bazuar në të drejtën e vetidentifikimit, sipas parashikimeve të legjislacionit për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë së Republikës së Shqipërisë dhe në rastet e parashikuara në këtë ligj”.

Referuar Vërtetimit nr. 259, datë 23.06.2025, të lëshuar nga Qendra për të Drejtat e Gruas Rome, vërtetohet se ankuesi i përket minoritetit Egjiptian.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të racës, si pjesë e pakicës kombëtare egjiptiane.

C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë të ankuesit nga ASHK DV Tirana Veri, me racën si shkak i mbrojtur

Si rregull, me qëllimin për të përcaktuar nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshme krahasuar me persona të tjerë ndodhur në një situatë të njëjtë apo të ngjashme me të, nevojitet “krahasuesi”. Në rastet dhe kushtet kur ky “krahasues” mungon, vlerësohet nëse subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në raport me të drejtat ligjore të tij.

Shqipëria i përmbush instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e ka zhvilluar kuadrin e saj ligjor në përputhje me standardet evropiane. Brenda këtij konteksti, Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor dhe nënligjor të përparuar që adreson çështjet e minoriteteve rome dhe egjiptiane bazuar në standartet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 17, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se: “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

¹⁰ GJEDNJ, *Timishev kundër Rusisë* (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragraf 55 (ECtHR, *Timishev v. Russia* (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005, para. 55).

¹¹ E drejta e vetidentifikimit

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon : “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”.

Në nenin 59, pika 1, germa b), të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet shprehimisht detyrimi i shtetit shqiptar për plotësimin e nevojave të shtetasve të tij, për strehim. Kështu, në këtë dispozitë parashikohet se: “1. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor¹².

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”) ka një vend të posaçëm. Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend

¹² Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;

b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;

c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;

d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Duke filluar nga tetori i vitit 2017, si romët ashtu edhe egjiptianët janë njohur si pakica kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Në mënyrë eksplicite, ligji nr. 97/2017 *“Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”*, sanksionon ndër të tjera, mbrojtjen e pakicave kombëtare nga diskriminimi (neni 8) 103.

Në nenin 8 të tij, pika 2, ligji nr. 97/2017, ngarkon institucionet publike, qendrore dhe vendore, me përgjegjësi për të miratuar dhe zbatuar masa për të: - garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës.

Në kuadër të procesit të integritit të Shqipërisë në BE, Qeveria Shqiptare ka miratuar disa dokumenta, siç janë Plani Kombëtar i Integritit Europian dhe Udhërrëfyesi për plotësimin e 5 Prioriteteve, që përcaktojnë masa konkrete për realizimin e këtij procesi. Pesë prioritetet kyçe që rezultojnë nga dialogu politik i nivelit të lartë midis qeverisë dhe BE-së përfshijnë, *“masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese”*.

Në pikën 3/7 *“Parimet Themelore”/“Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale”* – Plani i Veprimit (2021-2025) trajton nevojat për këto pakica kombëtare në një sërë fushash kyçe, duke përfshirë: arsimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimi urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale dhe regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integritit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Në Pjesën II – Qëllimet e Politikave dhe Objektivat Specifikë/ Qëllimet Strategjike të PKVBPPRE 2021-2025, pika 2, të Planit të Veprimit (2021-2025) parashikohet se një ndër qëllimet strategjike më të rëndësishëm të këtij plani është edhe përmirësimi i kushteve të strehimit për anëtarë të Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve jo formale.

Objekti Specifik 1, i këtij qëllimi strategjik përcakton shprehimisht rritjen e numrit të përfituesve romë dhe egjiptianë nga çdo program strehimi. Në elaborimin që i bëhet këtij objekti citohet: *“Anëtarë të komunitetit Rome dhe Egjiptianë vazhdojnë ende të përballen me vështirësi për sa i takon çështjeve të strehimit. Këtu përfshihen vështirësitë në aplikimin për strehim social. Në më të shumtën e rasteve ka mungesa në burimin e verifikueshëm të të ardhurave dhe dokumenteve të tjera si dhe procedurat janë të ndërlikuara. Kjo situatë e vështirë shoqërohet edhe me mungesën e strehëve të përkohshme (si, Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencave) dhe mungesës së alternativave afatgjata dhe e zgjidhjeve të qëndrueshme të strehimit për këto komunitete. Mbështetja me ndihmë ligjore falas për anëtarët e Minoritetit Rom dhe Egjiptian për problemet që ata mund të hasin gjatë procesit të përfundimit të legalizimit është domosdoshmëri. Shumë familje rome dhe egjiptiane jetojnë në objekte të paprivatizuara ende si: ish-ndërmarrje, pulari, pallate etj, ose i kanë nisur procedurat dhe nuk i kanë përfunduar ato, pra nuk zotërojnë titujt e pronësisë së vendbanimit...”*

Objekti specifik 2. Miratimi i kuadrit ligjor dhe bashkëpunimi midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor për adresimin e nevojave për legalizimin dhe strehimin social, parashikon se:

“Legalizimi i banesave ekzistuese të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane kërkon ndjekjen e një procedure të ndërlikuar. Për rrjedhojë lind nevoja për ofrimin e asistencës teknike në ndjekjen e procedurave të legalizimit. Pagesa e truallit dhe kostove të tjera që implikohen me legalizimin janë të papërbalueshme për shumë familje rome dhe egjiptiane. Këtë e vështirëson edhe më shumë mungesa e ndërgjegjësimit dhe e kapacitetit për ndjekjen e procedurave të legalizimit nga anëtarët e të dy komuniteteve”.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: *çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Me 6 qershor 2023, Komiteti Këshillimor për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (KKMK) ka miratuar opinionin e tij të pestë për Shqipërinë¹³, ku, ndër të tjera citon se:

“Kushtet e banimit për pakicat rome dhe egjiptiane janë gjithashtu shqetësuese, duke përfshirë ndarjen dhe diskriminimin në tregun privat të qirave, statusin e parregullt të pronës dhe kërcënimin

¹³ <https://rm.coe.int/5th-op-albania-summary-al/1680acf90f>

e dëbimeve me forcë. Siguria e banesave duke pasur parasysh në veçanti kërcënimet mjedisore ngre shqetësime serioze... ”.

KKMK, në rekomandimet për veprim të menjëhershëm për autoritetet shqiptare, ndër të tjera: “19 ...u kërkon autoriteteve të sigurojnë qasje në strehim të mjaftueshëm për romët, veçanërisht përmes sigurimit të investimeve për garantimin e aksesit në ujë të pijshëm dhe energji elektrike në zonat ku jetojnë romët. Autoritetet duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë garantimit të kushteve të sigurt të jetesës, gjithashtu duke pasur parasysh rreziqet që vijnë nga ndotja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike, si dhe sigurisë ligjore të kohëqëndrimit. Në këtë kontekst, rregullimi i pronësisë të pronave që zotërohen ose janë të banuara nga persona që i përkasin pakicave romë dhe egjiptiane është veçanërisht i rëndësishëm ”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Bazuar në nenin 82/2 të Kodit të Procedurave Administrative barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Në të njëjtën frymë është dhe ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie*

është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë të kundërtën.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁴

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkakun i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet, kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër.

Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës. GJEDNJ pranon si fakte ato vlerësime “*të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave...provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër, niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht*¹⁵”.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues: *Së pari*, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se ai i është nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e ASHK DV Tirana Veri.

Së dyti, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i pafavorshëm dhe i pabarabartë i subjektit ankues, nga ana e ASHK DV Tirana Veri, lidhet me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e ASHK DV Tirana Veri, si në raport me të

¹⁴https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁵ GJEDNJ, Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë (GC) paragrafi 147, (ECtHR, Nachova and others v. Bulgaria [GC] (Nos. 43577/98 and 43579/98), 6 July 2005). Kjo përsëritet në çështjen e GJEDNJ-së, Timishev kundër Rusisë (Numrat 55762/00 dhe 55974/00), 13 Dhjetor 2005, paragrafi 39 (ECtHR, Timishev v. Russia (Nos. 55762/00 and 55974/00), 13 December 2005), dhe GJEDNJ, D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13 Nëntor 2007, paragrafi 178 (ECtHR, D.H. and others v. the Czech Republic [GC] (No. 57325/00), 13 November 2007).

drejtën e tij ligjore, lidhur me kërkesën së për legalizim objekti informal, ashtu dhe në të drejtën për tu trajtuar me barazi para ligjit.

Subjekti ankues ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e ASHK DV Tirana Veri, përmes moshqyrtimit të aplikimit për legalizim banese, të bërë prej tij në vitin 2006.

Posedimi i shkakut të mbrojtur nga ana e subjektit ankues, rezulton i njohur dhe i pakundërshtuar nga ana e ASHK DV Tirana Veri, për faktin se nga ana e KMD-së i është bërë e ditur që ankuesi ka pretenduar diskriminim pikërisht për shkak të racës së tij.

Për sa më sipër, mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës¹⁶, Komisioneri vlerësoi se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga ASHK DV Tirana Veri, në raport me të drejtën e tij ligjore, lidhur me kërkesën e tij për legalizim objekti pa leje, dorëzuar më datë 21.03.2006, sa më sipër analizuar.

Komisioneri vlerëson se nga informacionet e dërguara nga ana e ASHK DV Tirana Veri, në asnjë rast nuk u arrit të provohej:

- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, që është raca dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë nga ana e ASHK DV Tirana Veri.
- Që veprimet dhe mosveprimet e këtij subjekti kundrejt ankuesit janë në përputhje me parashikimet ligjore, të drejta dhe të arsyeshme, si dhe që ai të ishte trajtuar në mënyrë të barabartë me aplikuesit e tjerë, kufitarë me të.

Për rrjedhojë, Komisioneri gjykon se, nga ana e ASHK DV Tirana Veri, pavarësisht njohjes të faktit se aplikimet për legalizime të bëra në vitet 2005-2006 duhet të kenë përparësi në marrjen në shqyrtim dhe faktit që ankuesi i përket komunitetit egjiptian, nuk ka bërë përpjekjet dhe veprimet e duhura, për të trajtuar kërkesën e ankuesit për legalizim të objektit të tij informal, në kohë, me drejtësi e barazi nga ana e tyre, por edhe detyrën funksionale për të cilën ky organ është krijuar dhe funksionon në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, “pala e akuzuar”, ASHK DV Tirana Veri, nuk arriti të provojë me dokumentacion apo prova të tjera që veprimet apo mosveprimet e institucionit nuk lidhen me shkakun e mbrojtur të poseduar nga ankuesi.

Pra në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, ASHK DV Tirana Veri:

- nuk ka shqyrtuar brenda një afati të arsyeshëm ligjor aplikimin e ankuesit për legalizim;
- nuk ka provuar dhe argumentuar shkaqet objektive apo subjektive të vonesës në shqyrtimin e aplikimit të ankuesit, kur ndërkohë aplikime të tjera të paraqitura më vonë nga ai, janë shqyrtuar me përfundim legalizimin e tyre;

¹⁶ Shih Ndarjen III, nëndarja A.I, të vendimit të KMD.

- nuk ka provuar se ka trajtuar ankuesin në mënyrë të barabartë (përsa i përket aspektit kohor) me kufitarët e tjerë, komshinj, që nuk i përkasin komunitetit egjiptian, në procedurën e legalizimit të objektit të tij.

Referuar dokumentit të publikuar në faqen zyrtare të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH)¹⁷: “Raport përfundimtar i auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë”, Komisioneri, evidenton se, në përmbajtjen e tij, ndër të tjera, theksohet se:

“Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1171/1, datë 16.01.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 16.01.2023 deri në datën 20.04.2023, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë u krye në terren auditimi “Financiar dhe i përputhshmërisë”.

Auditimi mbuloi periudhën prej datës 01.01.2021 deri në datën 31.12.2022.

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, zbatimi i kontratave të punimeve, zbatimi i rekomandimeve, mbi funksionimin, drejtimin dhe përputhshmërinë me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi të veprimtarisë së Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK, si dhe të disa Drejtorive kryesore të ASHK... ”.

Në pikën 2, të këtij dokumenti: “Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve”, ndër të tjera, pasqyrohen gjetjet si më poshtë, duke i cituar si të rëndësishme të lartë:

Përmbledhje e gjetjes

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Apelimit dhe Bashkëqeverisjes (DAB), u konstatua se për vitin 2021 kjo strukturë ka konstatuar se 30% e ankimeve lidhen me faktin se nga Drejtoritë Vendore të ASHK-ve, legalizohen objekte të specifikuara dhe jo objekte sipas blloqeve kadastrale. Pra ndërkohë që objekti fqinj është legalizuar, objekti tjetër i po së njëjtës periudhë vetë deklarimi në po të njëjtën zonë, nuk është legalizuar dhe nuk është kryer asnjë procedurë. Ky fenomen për vitin 2022 është konstatuar në masën 18% të ankimeve. Nga shqyrtimi i ankesave të marra gjatë vitit 2021, nga DAB në 369 raste është mbajtur qëndrim pro subjektit ankimues, ku pretendimet e tij kanë rezultuar të drejta dhe veprimet e Drejtorive Vendore të ASHK-ve nuk kanë qenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo situatë për vitin 2022 është reflektuar në 274 raste. Për vitin 2021 dhe 2022, respektivisht në 56 dhe 366 ankime administrative, nuk është arritur të nxirret një konkluzion i qartë nga DAB, pasi Drejtoritë Vendore nuk kanë përcjellë informacion të saktë, apo nuk kanë përcjellë fare informacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me detyrimet ligjore që rrjedhin nga detyra funksionale e Drejtorive Vendore të ASHK.

¹⁷ Raporti-përfundimtar-për-auditimin-e-ushtruar-në-Drejtorinë-e-Përgjithshme-të-Agjencisë-Shtetërore-të-Kadastrës.

Rekomandimi:

Me qëllim monitorimin e shkallës së përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi, të veprimtarisë së Drejtorive Vendore të ASHK-ve, trajtimin si duhet prej tyre të çështjeve të pronësisë së qytetarëve, për të gjitha rastet që Drejtoria e Apelit dhe Bashkëqeverisjes, gjatë trajtimit të ankimeve administrative të bëra nga qytetarët, konstaton shkelje të bëra nga Drejtoritë Vendore, të përcjellë këto shkelje pranë Drejtorit të Përgjithshëm. Drejtori i Përgjithshëm të analizojë të gjitha rastet me qëllim ndërprerjen e praktikave të gabuara të cilat nuk respektojnë kuadrin ligjor në fuqi, si dhe të marrë masa për personat përgjegjës.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, trajtimi i pafavorshëm dhe i pabarabartë i subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, si dhe është tërësisht i papërligjur në fakte, prova e dispozita ligjore.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, e ka trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe të pabarabartë, subjektin ankues, z. V.A, krahasimisht me kufitarët e tij sipërcituar në vendim, për shkak të racës, duke sjellë për pasojë diskriminimin e tij, përsa i takon mostrajtimit në kohë dhe në afat ligjor të kërkesës për legalizimin e objektit.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, në referencë të dispozitave të posaçme të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, është ekspozuar para veprimeve diskriminuese nga ana e ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 20, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, z. V.A, për shkak të racës, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, lidhur me mostrajtimin në kohë dhe në afat ligjor të kërkesës së tij për legalizim objekti informal.
2. Referuar pikës 1, të këtij Vendimi, të merren masa nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, për shqyrtimin e kërkesës, aplikimit me nr. 2241, datë 21.03.2005, të subjektit ankues Z. V.A, për legalizim banese.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA